

e pranuar me 04.07.2017.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT
Prizren, 22.06.2017

**Këshilli për Trashëgimi Kulturore
i Qendrës Historike të Prizrenit**

REKOMANDIM

Investitori, **DUHP-Prizren**, me seli në rrugën "R.Ademaj", me numrin e lëndës: 04-353-47456, me të cilën ka kërkuar prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor leje për ndërtimin e infrastrukturës për qasje në Kalanë e Prizrenit – sipas projektit.

Këshilli pas konklutimeve të gjëra me shoqërinë civile dhe shqyrtimin e lëndës në bazë të Ligjeve në fuqi, merr këtë vendim:

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor (DUPH) në Prizren ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e infrastrukturës për qasjen në Kalanë e Prizrenit. Për këtë qëllim Komuna e Prizrenit ka formuar edhe një komision për caktimin e kushteve për hartimin e projektit ideor, i cili komision përmes komunës së Prizrenit ka kërkuar nga IAK të jep kushtet e përgjithshme që duhet inkorporuar në hartimin e projektit. Në projektin e prezentuar shihet se infrastruktura për ngjitjen në kala bëhet përmes binareve, respektivisht kabinës lëvizëse që është vendosur në pjesën veri-lindore rrezë kalasë. Pikënisja është planifikuar të bëhet nga llogja e Marashit (e cila është monument nën mbrojtje si "Kompleksi i Marashit"), ndërsa arritja bëhet në cepin verior të kalasë ku është planifikuar të ndërtohen edhe disa ndërtesa përcjellëse rekreative-hoteliere. Largësia e kësaj strukture është rreth 5 metra nga muri verior i kalasë.

Këshilli nuk e jep pëlqimin për projektin ideor-ndërtimi i infrastrukturës për qasje në Kalanë e Prizrenit sepse është në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të dhëna nga IAK-u, si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore.

LIGJI NR. 02/L-88

Ligji për Trashëgiminë Kulturore

Neni 2

Definimi i nocioneve në kontekstin e ligjit

2.20

"Perimetri i monumentit" është kufiri i hapësirës së mbrojtur e lidhur me trashëgiminë kulturore të mbrojtur, që përcaktohet në një plan nga Institucioni kompetent.

2.22

“Sipërfaqe e mbrojtur” është një sipërfaqe që mund të përfshijë burime natyrore ose ambientale të mbrojtura, ose trashëgimi kulturor të paluajtshme siç është përcaktuar në nenin 2 të

Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

Neni 6

III. Trashëgimi arkitektuale

6.4.

Monumentet arkitektuale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.

LIGJI Nr. 04/L-066, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Neni 6,

2.4. aktivitetet që do të rezultojnë në ndryshimin permanent të morfologjisë natyrore të terrenit;

Anëtarët e këshillit që ishin të pranishëm;

1. Arbnor Morina / Anëtar / Kryetar
2. Igbalka Rama / Anëtare / Nënkyetare
3. Arnet Haskuka / Anëtare
4. Orhan Bislimaj / Anëtar
5. Svetlana Hadzic / Anëtare
6. Faridin Shala / Anëtar
7. Marin Përgjokaj / Anëtar

KTK, Pizren


